

WBIF – Instrumenti i Projekteve në Infrastrukturë Asistenca Teknike 6

Komisioni Evropian dhe institucionet kryesore financiare ndërkombëtare (BEI, BERZH, BKE, KfW, BB) po mbështetin vendin tonë për zhvillimin dhe përmirësimin e infrastrukturës së transportit, mjedisit, energjetikës dhe sektorit social e digjital, nëpërmjet programit WBIF (Fondi i Investimeve të Projekteve të Infrastrukturës në Ballkanin Perëndimor). Konsorciumi ndërkombëtar, SUEZ-IPF, është ngarkuar nga Drejtoria e Përgjithshme për Zgjerimin në Komisionin Evropian për të mbështetur Hekurudhën Shqiptare në përgatitjen e Projektit të Zbatimit për rehabilitimin e Linjës Hekurudhore Vorë – Hani i Hotit

Çfarë përfaqëson Hekurudha Shqiptare?

Hekurudha Shqiptare (HSH) është një shoqëri publike aksionere përgjegjëse për menaxhimin e rrjetit hekurudhor. HSH është përgjegjëse për përgatitjen dhe zbatimin e këtij projekti.

Përse është i nevojshëm ky projekt?

Rrjeti hekurudhor shqiptar është tejet i amortizuar duke ndikuar në shërbimet e munguara të transportit të mallrave dhe pasagjerëve. Projekti do të mundësojë ofrimin e shërbimeve bashkëkohore të transportit hekurudhor, përfshirë rritjen e shpejtësisë dhe sigurisë, në përputhje me standardet e BE-së. Linja do të rehabilitohet në gjurmën e hekurudhës egzistuese.

Në çfarë faze është ky projekt?

Projektimi dhe vlerësimi i ndikimit në mjedis sapo përfunduan. HSH, me mbështetjen e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë do të sigurojë të gjitha miratimet e nevojshme për të realizuar fazat e tenderimit dhe ndërtimit (nga 2021 e tutje) në varësi të mundësive financiare.

Cili është qëllimi i kësaj fletëpalosje?

Nëpërmjet kësaj fletëpalosjeje HSH synon të informojë institucionet dhe publikun e interesuar rreth këtij projekti.



Ky projekt zbatohet nga Konsorciumi SUEZ-IPF. Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim, i cili është mundësuar me mbështetjen e Bashkimit Evropian, nuk pasqyrojnë medoemos pikëpamjet e Komisionit Evropian.



Projekti i Zbatimit për Rehabilitimin e Linjës Hekurudhore Vorë – Hani i Hotit (WB16-ALB-TRA-01)

BASHKIA VAU I DEJËS

FLETËPALOSJE PËR INFORMIM PUBLIK

Qershor 2021



Cilat janë veprimtaritë e parashikuara në territorin e Bashkisë Vau i Dejës?

Në Bashkinë Vau i Dejës projekti do të përfshijë :

- **rehabilitimin e trasesë nga km 85+500 në km 95+300**, me një gjerësi 6.6m;
- zëvendësimin e superstrukturës (shinat, pjesët metalike dhe traversat);
- **ndërtimin e mureve mbajtës** për të shmangur rrëshqitjet e terrenit rrëzë kodrave;
- **zëvendësimin e tombinove, me të reja** me diametër të përshtatshëm për të siguruar qarkullimin e duhur të ujrave nga njëra anë e trasesë në tjetrën;
- **përmirësimin e kanaleve kulluese**, në të dy anët e hekurudhës;
- **zëvendësimin e urave të vogla, me të reja**, me gjerësi 6.0m;
- **ndërtimin e një ure të re mbi lumin Drin;**
- **ndërtimin e stacionit të ri Mjedë;**
- përmirësimin i **kalesave të autorizuar** – 5 të tilla në Bashkinë Vau i Dejës – me sistem të automatizuar sinjalizimi të standarteve evropiane për të garantuar sigurinë e këmbësorëve dhe automjeteve;
- **mbylljen e kalesave të paautorizuara** dhe mundësimin e lidhjes midis qendrave të banuara dhe kalesave në nivel nëpërmjet rrugëve të shërbimit;
- **rrethimin e stacionit Mjedë dhe linjës hekurudhore në të gjithë gjatësinë** me gardh mbrojtës;
- **plotësimin e rrjetit ekzistues rrugor** dhe rivendosjen e lidhjen e tij, që ndërpritet nga rrethimi i plotë i vijës hekurudhore, **me rrugë shërbimi** (ose ndihmëse);
- **ndërtimin e pengesave kundër zhurmave**

Cilat janë ndikimet e mundëshme në Mjedis?

Si pjesë e studimit është përgatitur dhe Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis. Zona nuk ka ndjeshmëri të veçantë mjedisore. Për ndikimet e mundshme në mjedis janë përcaktuar masat përkatëse zbutëse.

Megjithëse zona nuk ka ndjeshmëri të veçantë mjedisore, projekte rehabilitimi të këtij lloji shoqërohen nga një sërë ndikimesh të tilla si:

- Kufizim i qarkullimit në të dy anët e hekurudhës për shkak të rrethimit të saj;
- Dëmtim i infrastrukturës ekzistuese gjatë ndërtimit;

Cilat janë përfitimet e pritshme gjatë funksionimit të hekurudhës së rehabilituar?

- Produktivitet më i lartë bujqësor si rrjedhojë e përmirësimit të sistemit të kullimit;
- Shmangia e aksidenteve nga rrethimi i hekurudhës;
- Shmangia e aksidenteve nga ndërtimi dhe operimi i kalesave të sigurta dhe të automatizuara në nivel;
- Shmangia e aksidenteve nga ndërtimi dhe operimi i një sistemi bashkëkohor sinjalizimi e vëzhgimi;
- Rritje të shpejtësisë së trenave;
- Shmangia e erozionit për shkak të ndërtimit të mureve mbajtëse në segmentet ku hekurudha kalon rrëzë kodrave;
- Rivendosja e transportit hekurudhor të mallrave e udhëtarëve;
- Kthimi i stacioneve të trenave në pika referimi për shërbimet e tjera të transportit vendor si autobuzave, taksive apo dhe parkimit;
- Zhvillimi i ekonomisë vendore e kombëtare si pasojë e transportit hekurudhor;
- Rritje e punësimit e si rrjedhim i zhvillimit të ekonomisë duke rritur kështu cilësinë e jetës dhe sigurisë për qytetarët.

Kompensimi i tokës?

Blerja apo marrja me qera e tokës do të bëhet sipas ligjit Nr. 8561/1999 “Për Shpronësimet”, i ndryshuar me ligjin Nr.11/2020 dhe VKM-ve në zbatim të tij, përfshirë marrjen e të gjitha hapave të mundshëm për mënjanimin e shpronësimit.

Për këtë projekt, nevojitet një sipërfaqe toke për hapjen e rrugëve të reja të shërbimit dhe lidhjen e tyre me kalesat në nivel;

Toka për rrugët e shërbimit do të shpronësohet (nga pronarët e ligjshëm) prej shtetit nëpërmjet një VKM-je të posaçme dhe bazuar në vlerën e tregut dhe standartet e BERZH-it.

HSH-ja do të sigurojë marrëveshjet e duhura me pronarët e ligjshëm për shitblerjet e tokës dhe për qiramarrjet ose kompensimet e pasurisë personale.

Ku mund të merret më tepër informacion?

- Pyesni përfaqësuesit e bashkisë apo njësisë suaj administrative;
- Vizitoni faqen e internetit të Hekurudhës Shqiptare <https://hsh.com.al/> apo bashkisë suaj <http://www.vaudejes.gov.al/>

Ku mund të dërgoni vërejtjet, ankesat, sugjerimet?

Dërgojini në adresën:

Hekurudha Shqiptare Sh.a

Rruga “Egnatia”, Nr. 3 Durrës, Shqipëri

Tel: +355 67 22 21 452 / +355 52 22 037

E-mail: ankesat@hsh.com.al